

Revolucioni madh borgjez në Francë



Revolucioni Francez (1789 – 1799) ishte një periudhë e përgjakshme që përfshiu të gjithë **Francën** për arsye kryesisht sociale dhe politike. Kjo shënoi fundin e monarkëve në Francë dhe ardhjen e një rendi të ri, që tronditi të gjithë **Evropën**.

Kur **Luigji XVI** thirri parlamentin, ai shpresonte të fitonte sërish mbështetjen e masave të popullsisë Franceze. Reformat ekonomike sipas tij do të shuanin revoltën dhe do të risillnin stabilitetin në vend. Për tu theksuar është se parlamenti nuk ishte mbledhur që më 1614, dhe askush nuk mund ta parashikonte se çfarë do të trajtonin deputetët e tre klasave kur ata do të takoheshin në Versajë.

Fundi i revolucionit me dekapitimin e mbretit (**Luigji XVI**) dhe mbretëreshës (**Marie Antoinette Josèphe Jeanne de Habsbourg-Lorraine**), do të sillte në pushtet jakobinët me në krye Maksimilian Robespierin, i cili legjitimoi *Regjimin e Terrorit*.

Deficiti i madh i shtetit dhe pakënaqësia popullore e detyruan Luigjin XVI që në maj 1789 të mblidhte Përfaqësinë e Përgjithshme, e cila nuk ishte thirrur gjatë 2 shekujve. Përfaqësuesit (deputetët) e shtresës së tretë, pa vullnetin e mbretit e shpallën veten Asamble Kushtetuese dhe deklaruan se nuk do të shpërndaheshin pa i dhënë vendit kushtetutën. Në mbrojtje të Asamblesë, më 14 korrik 1789 populli i armatosur i Parisit sulmoi dhe pushtoi kështjellen burg, Bastijën, që ishte simbol i absolutizmit. U liruan të burgosurit dhe u ngrit flamuri trengjyresh (i bardhe, i kuq, blu) i revolucionit. Kjo datë, 14 korriku, shënoi fitoren mbi regjimin e vjetër dhe vendosjen e regjimit të ri. Sot kjo ditë është festa kombëtare e Francës. Në provinca u pushtuan kështjellat, u dogjën dokumentet e detyrimeve dhe kudo u vendosën

organe të reja të zgjedhura nga populli. Revolucioni fitoi. Për të mbrojtur Asamblenë u krijua një forcë e re ushtarake e përbërë nga vullnetarë, që u quajt Garda Kombëtare. Kjo forcë u bë ushtria e revolucionit.



Revoltat Popullore



Luigji XVI.



Marie Antoinette (1768).

Më tutje akoma, ndërkohë që *Asambleja Kombëtare* po punonte për kushtetutën e re (ata kishin punuar që nga korriku i 1789), qytetarët e **Parisit** dhe fshatarësia në rrethinat e kryeqytetit filluan revoltat që do ti jepnin revolucionit një pamje krejt tjetër; një pamje akoma më radikale. Qytetarët dhe fshatarët e thjeshtë kishin menduar se reformat do të ishin të shpejta. Ata kishin shpresuar që të liroheshin shpejtë nga taksat e rënda dhe nga varfëria e tejskajshme, por mbledhjet e Asamblesë Kombëtare kërkonin]trupa të armatosura rreth Parisit. Të gjithë këto faktorë, të ndihmuar edhe nga një pasiguri e madhe, bënë që qytetarët e Parisit të hidheshin në revoltë.

Thashethemet u vërtetuan shpejtë. Luigji XVI, i ndikuar vazhdimisht nga gruaja e tij e bukur Maria Antonieta, do të sillte trupa ushtarake në Versajë. Si një veprim i gabuar ky, në një kohë të papërshtatshme, mbreti vetëm sa shtoi akoma më shumë frikën e qytetarëve se ato trupa “nesër ose pasnesër” do të godisnin Asamblenë Kombëtare. Kjo sipas masave ishte një lëvizje e mbretit për të shtypur revolucionin. Reagimi i turmës erdhi shpejtë. Më 14 korrik të 1789, një turmë e revoltuar sulmoi Bastijën. Bastija ishte një burg ku zakonisht hidheshin kundërshtarët politik, ndaj sulmi ndaj saj u pa nga të gjithë si një goditje ndaj padrejtësive që i ishin bërë atyre deri atëherë.

Shqetësimet do të përfshinin edhe rrethinat e Parisit. Gjatë verës të po atij viti, fshatarët u kapën në një ankth të papërshtatshëm që u emërua si “Frika e Madhe.” Thashethemet u përhapën si era nga një fshat në fshatin tjetër sikur banditë dhe banda hajdutësh sulmonin fshatrat në të gjithë Francën duke vjedhur dhe bastisur të mbjellat dhe të korrat. Në këtë gjendje paniku, fshatarët shtrënguan në duar armët për tu mbrojtur nga një armik virtual që në vërtetë ishte thjeshtë pjellë e thashethemeve frikë-ndjellëse. Kur “bandat e hajdutëve” dhe “banditëve” nuk u dukën në horizont, fshatarët e tromaksur nga “Frika e Madhe,” sulmuan fisnikët e tyre. Ata shkatërruan, vodhën dhe bastisën depot ushqimore, dogjën regjistrat e taksave, si edhe u zotuan se kurrë më nuk do të paguanin ndonjë detyrim feudal. Ashtu si edhe parisienët, edhe fshatarët po zhvillonin një revolucion (në mënyrën e tyre) kundra regjimit të vjetër.

Reforma e të tjera

Duke parë trazirat në Paris dhe në të gjithë Francën, Asambleja Kombëtare kaloi në veprim. Në natën e 4 gushtit, pjesëtarë të shumtë të asamblesë mbajtën fjalime të gjata dhe pasionuare në mbrojtje të reformave. Mendohet se një nga vetë fisnikët, pretendoi që edhe këta të fundit të paguanin taksa. Një tjetër propozim ishte heqja dorë nga e drejta fisnike e gjuetisë (që ishte një nga hobit e preferuara të Luigjit XVI). Duke guxuar më shumë, edhe kleri vetë deklaroi se ishte i gatshëm të hiqte dorë nga pasuritë e luksit në se këto do i shërbenin reformave. Me pak fjalë, deri në agim asambleja hodhi poshtë të gjitha traditat e fisnikëve. Fisnikët tashmë mund ti gëzoheshin vetëm titujve të tyre. Një tjetër hap i rëndësishëm ishte edhe barazia e të gjithë meshkujve të rritur për tu punësuar në institucione shtetërore dhe fetare.

Mbledhja në atë natë gushti bëri shuma hapa para. shkurt, mjafton të përmendim citatin e një fisniku të moderuar Francez, *Conte de Merabeau*:

“ – Në se nuk është për të qeshur... shpenzuan një muaj të plotë duke u kapur mbas gabimeve ortografike, se si shkruhej kjo ose ajo fjalë. Por ju desh vetëm një natë për të përmbysur të gjithë rregullat e vjetra të mbretërisë.”

Para se të mbaronte gushti, Asambleja Kombëtare hartoi dhe vuri në zbatim të *Deklaratën e të Drejtave të Njeriut*. Kjo deklaratë përmbante shumë ide filozofike të iluminizmit dhe u frymëzua nga *Karta e të Drejtave* e hartuar në Angli. Një ndikim tjetër të madh pati edhe *Deklarata e Pavarësisë* amerikane. Deklarata e të drejtave të Njeriut (deklarata franceze), u përkthye në shumë gjuhë të tjera dhe u përhap në të gjithë Evropën. Nën këto ide, shumë vende të tjera, edhe [Shqipëria](#), do të bënin revolucionet e tyre nën shembullin Francez. Pra deklarata bënte thirrje për barazi të të gjithë personave dhe siguri të pronës. Këto mendime do të parashtroheshin edhe në kushtetutë.

Zhvillime të mëtejshme

Ndërkohë që juristët dhe zyrtarët hartonin dhe debatonin reformat, qytetarët e revoltuar të Parisit hynë në asamble duke i kujtuar atyre se duhet të pyeteshin edhe kërkesat e tyre. Debati ishte pak i vështirë të qetësohej pasi shumica e protestuesve ishin me arsim të mesëm dhe nuk mund të kuptonin lehtë gjuhën e ngarkuar juridike.

Gjatë tetorit të 1789 më datë 5, me mijëra gra të revoltuara do të marshonin drejt Versajës, ku ndodhej mbreti me familjen e tij. Gratë ishin të revoltuara për çmimet e larta të ushqimeve. Një tjetër arsye e marshimit ishte si gjithmonë dyshimi se mbreti dhe mbretëresha austriake po komplotonin kundra Asamblesë Kombëtare. Ato kërkuan që mbreti të kthehej me ta në Paris së bashku me familjen e tij. Atje, ato do ta kishin më të thjeshtë të kontrollonin aktivitetet e mbretit. Luigji XVI pranoi duke shmangur në këtë mënyrë dhunën.

Kthimi i mbretit në Paris ishte një skenë e paparë. Rikthimi i mbretit habiti të gjithë. Luigji XVI, i hipur mbi një kalë parakaloi në rrugët e Parisit i ndjekur nga një turmë grash që përshëndesnin me gëzim. Mbreti vetë mbante të veshur shiritin tre ngjyrësh; blu, të bardhë dhe të kuqe, ngjyra këto që revolucionarët i kishin mbartur nën flamurin e tyre. Kjo gjë, i bëri revolucionarët të mendonit se ishin pikërisht ata që e kishin në dorë Francën tashmë. Asambleja Kushtetuese gjithashtu u zhvendos në Paris sepse në këtë mënyrë revolucionarët mund ta analizonin punën e tyre akoma më mirë.

Pasojat ekonomike, politike dhe sociale

Në fakt shumë do tju dukej periudha e revolucionit koha në të cilën Franca do të shkatërrohej përfundimisht, por nuk ishte ashtu. Rezultatet ishin shumë të mëdha duke qenë se kanë qenë produkti i kauze të hershme.

Pasojat e revolucionit nuk ishin aspak të papërfillshme, ato cuan në një ndryshim rrënjësor në sistemin e politik, ekonomia u rrit, dhe shpërndarja klasore ndryshoi. Nga e gjithë situata e ngatërruar e Francës, kaosi politik dhe ekonomik që përfundoi në përmbysjen e Direktoratit në 1799, ishte Napoleon Bonaparti ai që vendosi rregull dhe i solli Francës lavdinë e mëparshme. Në fakt regjimi i tij ishte

akoma më i fortë dhe absolutist sesa ai i Luigjit të XIV por, në këtë rast francezët donin unitet dhe lulëzim të vendit të tyre.


Kështu uniformiteti i ligjit dhe i institucioneve u zbatua dhe afirmua në të gjithë Francën, privilegjet ligjore të disa klasave u zhdukën, sistemi i vjetër agrar u hoq, një pjesë e madhe e tokave mbretërore, të fisnikëve dhe të klerit u shpërndanë dhe iu shitën personave të shtresës së mesme dhe të ulët me cmime relativisht të ulëta. Sistemi i ri fiskal i tatonte njerëzit sipas fitimeve dhe u hoqën të gjitha pengesat për tregëtinë brenda vendit. Cdo profesion u bë pa pagesë dhe secili e merrte atë në bazë të talentit dhe aftësive. Besimi fetar dhe fjala kishin pothuajse një liri të plotë.

Të gjitha këto produkte të revolucionit bënë që francezët të duronin të gjitha reformat dhe masat drastike që i sollën ato.



ARSYET PER REVOLUCIONIN

- Në gjysmën e dytë të shek. XVIII, Franca ka qenë monarki absolute me perfaqesim klasor.
- Në krye të shtetit ka qenë mbreti Lui XVI i cili ka pasur pothuajse pushtet absolut.
- Pasi që klasat ishin ndare në tre pjesë, klasa e tretë edhe pse i ka paguar detyrimet e veta ndaj shtetit, nuk ka pasur pozite vendimmarrese në shtet.
- Në këtë periudhë Franca ka rënë në krize të rënda financiare.
- Nën presion të klases së tretë, mbreti Lui XVI (1774-1792) më 5 maj të vitit 1789 në Versajë e ka mbledhur kuvendin e klasave shtetërore.
- Kur mbreti shpalli se vendosen tatime të reja të cilat do të duhet t'i paguajnë klasa e tretë, perfaqësuesit e kësaj klase e kanë kundërshtuar menjëherë këtë propozim dhe shpallën Kuvendin popullor.



Fillimi dhe rrjedhat e Revolucionit

Edhe pse mbreti ishte pajtuar me punën e Kuvendit, fshehurazi është përgatitur që me ushtri të shpërndajë. Kjo ka shkaktuar pakënaqësi të popullit me çka më 14 korrik 1789, është marrë burgu i Bastiljes - simboli i absolutizmit mbretëror.

Kjo e ka shënuar fillimin e Revolucionit Francez. Sipas shembullit të Parisit, revolucioni ka fituar edhe në pjesët e tjera të Francës. Fitoren e ka shfrytëzuar borgjezia e madhe dhe e ka marrë pushtetin.

Nepermjet Kuvendit popullor është miratuar Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit. Në vitin 1791, Kuvendi kushtetues ka miratuar kushtetutën me të cilën Franca është shpallur monarki kushtetuese dhe është hequr ndarja e qytetareve në klasa.



Shpallja e Republikës

Frika nga përhapja e revolucionit në v. 1792 ka shkaktuar intervenim të disa shteteve feudale kundër Francës.


Lufta kundër Koalicionit Feudal e ka përkeqësuar pozitën e popullit. Ushtria franceze në frontet ka pësuar disfata.

Në gusht të v. 1792, populli i Parisit e ka sulmuar pallatin mbretëror Tiljeri dhe e ka mbyllur mbretin.

Pas këtyre ngjarjeve është thirrur Kuvendi i ri popullor, i quajtur Konvent i cili e ka shpallur Francën Republikë.

Zhirondistët konsideronin se revolucioni ka përfunduar dhe kanë dashur ta shpëtojnë mbretin, ndërsa Jakobinasit konsideronin se revolucioni duhet vazhduar deri në shkatërrimin e sistemit feudalo-absolut.


Nën presionin e jakobineve, Konventi i ri ka dënuar me vdekje mbretin dhe mbretëreshën, të cilat pastaj janë egzekutuar.



DIKTATURA JAKOBINE

Pas egzekutimit të mbretit, Koalicioni feudal e ka perforcuar luftën kundër republikës borgjeze ashtu që në brendinë e Francës ka shpërthyer edhe kundërrevolucioni. Per shkak të pakenaqesise nga sundimi i zhirondistëve, pushtetin e kanë ndermarre jakobinet të udhëhequr nga Maksimilian Robespjeri të cilët kanë vendosur diktaturë e njohur si 'Diktatura Jakobine'.

Pas ndermarrjes të pushtetit edhe të jakobinet kanë filluar percarje. Kete e kanë shfrytëzuar kundërshtarët e tyre të cilët e kanë vrarë Robespjerin më së rast në v. 1794, diktatura jacobine është abroguar ndërsa pushtetin në Francë e ka ndermarre borgjezia e madhe.



NAPOLEON BONAPARTA

Borgjezia e madhe e vazhdoi luftën kundër koalicionit feudal të cilën e përbenin Austria, Prusia Spanja.

Në këtë luftë u dallua gjenerali i ri NAPOLON BONAPARTA...

Si komandant i forcave franceze në Uajing Valtore ka kore fitore mbi Austriën.

Në Paris ka kryer grushtet dhe ka krijuar një organ të ri i quajtur KONSULAT. Konsulli i parë ka qenë Napoleoni... I emëruar Konsull i parë Napoleoni e rindërtoi administracionin e Francës në një strukturë qendrore, territori ndahej në departamente, distrikt dhe komuna, të ushequra nga prefektë, ndihmës-prefektë dhe kryetar bashkie..

Sajtografia:

<https://prezi.com/84dfqtqllu2s/revolucion-i-borgjez-francez/>

https://sq.wikipedia.org/wiki/Revolucioni_francez

Ju deshiroj shendet dhe sukses

Prof.Besim Ramadani